



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK, dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.278/1 prot., i AK, datë 25.05.2023, “Përcjellja e formularit të përqendrimit dhe dokumentacionit”, në lidhje me përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë AMB Construction SHPK nga shoqëritë AGNA SHA, INFO-Telecom SHPK, dhe TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK

Referuar dokumentit “Kontratë shitblerje (Kuote)”, palët në marrëveshje janë:

**Pala blerëse:**

**Blerësi 1: AGNA SHA**, është një shoqëri aksionere, me objekt aktiviteti: Import eksport të mallrave industriale e ushqimore, materiale ndërtimi, prodhime bujqësore e blegtorale, prodhim e shitje pije alkolike, pjesë këmbimi, tregtimin e tyre me shumicë dhe pakicë si dhe transport mallrash dhe udhëtarësh, etj.

**Blerësi 2: TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT SHPK**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: Marrja përsipër e hartimit të projekteve të ndryshme ndërtimore të fushave të ndryshme dhe të realizimit të ndërtimit në përgjithësi; ndërtim në fushën e turizmit, të infrastrukturës, qendrave të biznesit, aktivitet në blerjen, shitjen, qiradhënien e zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme, etj.

**Blerësi 3: Info-Telecom SHPK**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: Ofrimin e shërbimeve dhe çdo aktivitet në fushën e telekomunikacionit të përcaktuara në legjislacionin përkatës shqiptar. Përfaqësimi i shoqërive të ndryshme të huaja në territorin shqiptar. Aktivitete në blerjen, shitjen, qiradhënien e zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme, etj.

**Pala shitëse: Z. M. GJ.**, është person fizik dhe ortak i vetëm i shoqërisë target AMB Construction SHPK.

**Shoqëria Target: AMB Construction SHPK**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: Dhënie me qira e impianteve fotovoltaike, tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike,

impianteve/paneleve fotovoltaike, elektroshtëpiake, elektronike, sistemeve/impianteve termike të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), sisteme për mirë menaxhimin e energjisë, sisteme ndriçimi, të telekomunikacionit si dhe impianteve të tjera të ngjashme të destinuara për objekte civile dhe industriale, për sektorë të ndryshëm. Tregtim i energjisë nga burime të rinovueshme. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**